



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 06-350/03-16798/25
Kaçanik, 29.07.2025

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 4 paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 52/08 maj 2009), të neni 6.2 (f) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të emailit të MAPL të datës 16.07.2025, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës 01Nr. 350/03-16798/25, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 korrik 2025, mori këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT 01 NR. 06Nr.350/02-10931/25 TË DATËS 30.05.2025 PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELËS KADASTRALE 00515-1 NË ZK KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 06-350/02-10931/25 të datës 30.05.2025 për shpallje në interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik, për shkak të një gabimi teknik të lëshuar në vendim.
2. Ndryshim plotësimi i vendimit si në pikën 1, bëhet në pjesën hyrëse të vendimit, të pasuesi me tekstin: “Ligji Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Rregullorja (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës” hiqet, ndërkaq shtohet pasuesi me tekstin: “Në bazë të nenin 4 paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme”.
3. Të pika 2 e Vendimit, shtohet paragrafi 2.2, me përmbajtje si vijon: Qëllimi i shpalljes së interesit publik është shpronësimi.
4. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.
5. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, respektivisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 06-350/03-16798/25
Kačanik, 29.07.2025

Na osnovu člana 12.2 (d) u vezi sa članom 17 (b), (c), (f) Zakona br. 03/L-40 o lokalnoj samoupravi Republike Kosovo (Službeni glasnik Republike Kosovo br. 28/04. jun 2008. godine), članom 4 stav 2, tačka 2.4 Zakona 03/L-139 o eksproprijaciji nepokretne imovine (Službeni glasnik Republike Kosovo br. 52/08. maj 2009. godine), članom 6.2 (f) i (k) Statuta opštine Kačanik od 25.09.2008. godine i izmenom i dopunom Statuta opštine Kačanik 01.br.60/01-12895/2020 od 30.06.2020. godine, imejlom MLGA od 16.07.2025. godine, Predloga odluke Predsednik Opštine Kačanik preko Direkcije za urbanizam, katastar i zaštitu životne sredine koju je Skupština opštine 01 br. 350/03-16798/25, Skupština Opštine Kačanik na sednici održanoj 29. jula 2025. godine, donela je sledeće:

O D L U K A

O IZMENI I DOPUNI ODLUKE 01 BR. 06 br. 350/02-10931/25 OD DANA 30.05.2025. O JAVNOM INTERESU KATASTARSKE PARCELE 00515-1 U ZK KAČANIK

1. Ovom odlukom se stavlja van snage Odluka Skupštine Opštine 01 br. 06-350/02-10931/25 od 30.05.2025. godine za proglašenje u javnom interesu katastarske parcele 00515-1 u Katastarskoj zoni Kačanik, zbog tehničke greške donete u odluci.
2. Izmena i dopuna Odluke kao u tački 1, vrši se u uvodnom delu odluke, sledeći tekst: „Zakon br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, kao i Pravilnika (QRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupka za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine“ se briše, dok se sledeći tekst dodaje: „Na osnovu člana 4 stav 2, tačka 2.4 Zakona 03/L-139 o eksproprijaciji nepokretne imovine“.
3. U tački 2 Odluke dodaje se stav 2.2, sa sledećom sadržinom: Svrha proglašenja javnog interesa je eksproprijacija.
4. Ostali deo odluke ostaje nepromenjen.
5. Ova odluka stupa na snagu 30 dana nakon registracije u Kancelariji protokola nadzornog organa - MLGA, odnosno 7 dana nakon objavljivanja na zvaničnoj veb stranici opštine.
6. Sprovođenje ove odluke obezbeđuju: Predsednik Opštine i Direkcija za urbanizam, katastar i zaštitu životne sredine.

O ovoj odluci dostavljaju se: Predsednik Opštine; Direkciji za urbanizam, katastar i zaštitu životne sredine (preko ove Direkcije se obaveštavaju stranka i drugi relevantni mehanizmi); Direkciji za budžet i finansije; Arhivi.

Predsedavajući Skupštine
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik


01Nr. 06-350/02-10931/25
Kaçanik, 30.05.2025

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit Nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ((Gazeta Zyrtare Nr. 10/03 Prill 2019), të neni 29.5 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 6.2 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, duke vendosur sipas Propozim Vendimit Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit, 01Nr. 06-350/02-10931/25 të datës 16.05.2025, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 30 maj 2025, mori këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË
PARCELES KADASTRALE 00515-1 NË ZK, KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, SHPALLET me interes publik prona e paluajtshme në Zonën Kadastrale Kaçanik me pronësi private të personit fizik
2. Sipas pikës 1. të këtij Vendimi, shpallet me interes publik parcela e pronës si vijon:
 - 2.1 Parcela Kadastrale P-70917048-00515-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 9958 m^2$, në pronësi NASA HOLDING SH.P.K. me pronar Liridon Pallosi, me vendndodhje rrugën: "Ismail Raka", ZK Kaçanik (shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $1782.73 m^2$, e cila nevojitet për vazhdimin e rrugës, rruga: "Ismail Raka", me Lagjen e Re deri te Lumi Nerodime, sipas projektit për lidhjen e rrugës).
3. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë dokumentet bashkangjitura: Situacioni i terrenit, Kopja e planit, Certifikata e pronës.
4. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

FW:

Makfire Malsiu

Wed 16/07/2025 09:53

To: Besmir Krasniqi <besmir.krasniqi@rks-gov.net>;

From: Vjosa Ahmetaj <Vjosa.Ahmetaj@rks-gov.net>

Sent: Monday, July 14, 2025 2:39 PM

To: Makfire Malsiu <Makfire.Malsiu@rks-gov.net>

Cc: Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Besim Q. Ilazi <besim.q.ilazi@rks-gov.net>; Kemajl Murseli <kemajl.murseli@rks-gov.net>; Sabedin Vishi <sabedin.vishi@rks-gov.net>; Qamil Stagova <qamil.stagova@rks-gov.net>

Subject: RE:

E nderruar,

MAPL ju sqaron se Vendimi në fjalë duhet që të plotësohet dhe ndryshohet përmes Kuvendit Komunal të Kaçanikut, baza ligjore të jetë Ligji për shpronësim dhe qëllimi i shpalljes së interesit publik të jetë shpronësimi.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj

From: Makfire Malsiu

Sent: Friday, July 11, 2025 10:50 AM

To: Vjosa Ahmetaj

Cc: Besim Q. Ilazi; Kemajl Murseli; Sabedin Vishi; Qamil Stagova

Subject:

Përsëritet Vjosa,

Po ju shkruaj lidhur me Vendimin për shpallje me interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik, të datës 30.05.2025, i cili vendim nga MAPL është vlerësuar pozitiv, ndërsa në vlerësim të ligjshmërisë, është theksuar **që të pezullohet zbatimi i vendimit, deri me konstituimin e organeve të reja të komunës**, në pajtim me nenin 10 të ligjit Nr. 06/L-992 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nga dita kur Presidenti i shpallë zgjedhjet lokale dhe nenin 33 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Kur është hartuar Vendimi, jam thirrur gabimisht në dispozita të këtij ligji dhe të kësaj rregulloreje, në vend se të thirrem në nenin 4 paragrafi 2 e ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, pasi që kjo pronë nuk ka të bëjë me këmbim, por me shpallje të interesit, me qëllim të shpronësimit të saj, pasi vendimet për shpallje interesi, për shpronësim, nuk ka nevojë të pezullohen.


Andaj kërkoj sqarim se, a mundemi të korrigjohim vendimin e Kuvendit të Komunës, apo nga MAPL të rishqyrtohet ky vendim dhe të hiqet pezullimi i këtij vendimi, me qëllim të ekzekutimit të tij, dhe të zhvillohen procedurat e shpronësimit të pronës në fjalë, pasi kemi të bëjmë me vazhdimin e një rruge që është me interes publik dhe shumë e nevojshme për lidhjen e rrugëve sipas projektit.

Kërkojmë ndjesë për aplikimin gabim të dispozitave ligjore, që po na ndodhin, duke i marrë tekstin, copi paste.

Bashkangjitur:

1. Vendimi i KK ;
2. Vlerësimi i ligjshmërisë nga MAPL.

Respekt!



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	<i>PËR</i> Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së <i>Elbert</i> Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL <i>Jeton</i>
Nga:	Erbilin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL <i>EH</i> Data: 12.06.2025 VI-020-355
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit <i>Xhevat</i>
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës <i>Vjosa</i>
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullosës (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e kuvendit të komunës në vijim:

Vendim 01 Nr. 06-350/02-10931/25 për shpallje në interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK. Kaçanik

I miratuar më datë: 30.05.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.06.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se:

- Akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.
- Pezullohet zbatimi i Vendim 01 Nr. 06-350/02-10931/25 për shpallje në interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK. Kaçanik.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2025, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 06-350/02-10931/25 për shpallje në interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK. Kaçanik .

MAPL, konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, është bazuar në nenin 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04), në nenet 24 dhe 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 29.5 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 6.2 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshim plotësimit të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01 Nr. 60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, dhe ka për qëllim vazhdimin e rrugës "Ismail Raka", me Lagjen e Re deri të Lumi Nerodime (sipas projektit për lidhjen e rrugës).

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datë 30.05.2025, është miratuar me 19 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Sipas neni 10 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës: *"Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i komunës nuk mund të merr asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nga dita kur Presidenti shpall zgjedhjet lokale"*, po ashtu edhe neni 33, paragrafi 1, i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, përcakton se: *"Kuvendi i Komunës dhe Ekzekutivi i Komunës nuk mund të merr asnjë vendim dhe të gjitha procedurat të cilat zhvillohen lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës pezullohen nga dita kur Presidenti shpall zgjedhjet lokale deri në konstituimin e organeve të komunës"*, andaj pezullohen të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës pasi që me Vendimin Nr. 22/2025 të datës 09.06.2025 Presidentja e Republikës së Kosovës ka shpallur zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës të cilat do të mbahen me datë 12.10.2025.

Komuna pas konstituimit të organeve të komunës të dalura nga zgjedhjet lokale që do të mbahen me datë 12.10.2025, mund të vazhdojë me procedurën e këmbimit të pronës komunale.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.